



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Datë: 15.02.2023

**Raporti i monitorimit të Planit të Veprimit 2020-2022 të Strategjisë për Zhvillim Rajonal
2020-2030**

Vizioni i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është Zhvillimi i balancuar dhe i qëndrueshëm rajonal me rritje të kohezionit socio-ekonomik e territorial.

Misioni i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal është Zhvillimi i politikave dhe programeve për zhvillim rajonal dhe të bashkëpunimit ndër rajonal për të reduktuar pabarazitë rajonale.

1	PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE <p>Strategjia për Zhvillim Rajonal (2020-2030) është dokumenti themelor që përcakton kuadrin strategjik të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për arritjen e zhvillimit të balancuar dhe të qëndrueshëm të rajoneve zhvillimore, me qëllim të tejkalimit të dallimeve/pabarazive brenda dhe ndër-rajonale në kontekst të zbatimit të politikës evropiane të kohezionit dhe rritjes së qëndrueshme ekonomike dhe gjithëpërfshirëse.</p> <p>Strategjia për Zhvillimit Rajonal (2020-2030) përcakton qëllimet dhe prioritetet afatgjata 10-vjeçare të politikës së zhvillimit rajonal, që mundëson koordinimin e politikave sektoriale në territorin përkatës të rajonit zhvillimor dhe mbështetë sinkronizmin mes tyre. Strategjia ka një rol të rëndësishëm për arritjen e përputhshmërisë dhe sinergjisë ndërmjet qëllimeve dhe prioritetëve të politikës së zhvillimit rajonal dhe politikave dhe strategjive sektoriale, të cilat kontribuojnë në zhvillimin e balancuar të rajoneve zhvillimore.</p>
2	PROGRESI NË ZBATIMIN E OBJEKTIVAVE TË DOKUMENTEVE STRATEGJIKE

	<p>Strategjia për zhvillim rajonal, përcakton politikat prioritare të Qeverisë, në nivel afatmesëm dhe jep orientimet strategjike zhvillimore afatgjate.</p> <p>Me qëllim të monitorimit të implementimit të strategjisë për Zhvillim Rajonal, Ministria e Zhvillimit Rajonal, në bazë periodike harton raporte monitoruese për implementim të aktiviteteve sektoriale, aktiviteteve të komunave, OJQ-ve dhe aktiviteteve të MZHR-së, për të pasqyruar nivelin e realizimit dhe përbushjes së detyrimeve sektoriale që dalin nga kjo strategji.</p> <p>Raporti i cili i shërben Qeverisë për të parë nivelin e zbatimit të strategjisë si dhe për të ri-orientuar nëse është e nevojshme politikat zhvillimore, i shërben institucioneve të cilat kanë përgjegjësi konkrete në zbatimin e aktiviteteve të kësaj strategjie, organizatave jo qeveritare, organizatave ndërkombëtare dhe të gjitha palëve tjera të interesuara, për të parë progresin e të arriturave nga fusha e zhvillimit rajonal, si dhe për orientimet programore për periudhën e ardhshme sa i përket zhvillimit rajonal.</p>
<p>2.1</p>	<p>PROGRES KUNDREJT OBJEKTIVIT: [titulli i objektivit]</p> <p>Strategjia për Zhvillim Rajonal ka gjithësej tri objektiva të cilat janë:</p> <p>Objektiv Strategjik: 1. Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal; Objektiv Strategjik: 2. Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale; Objektiv Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.</p> <p>Në kuadër të Objektivit 1, me qëllim të realizimit të aktiviteteve konkrete, janë parashikuar dy objektiva specifike, si vijon:</p> <p><i>Objektivi Specifik:</i> 1.1 Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar; <i>Objektivi Specifik:</i> 1.2 Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.</p> <p>Shih grafi-konin më poshtë:</p>



Në objektivin 2, janë parashikuar edhe 4 objektiva specifike, si vijon:

Objektivi Specifik: 2.1 Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve;

Objektivi Specifik: 2.2 Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;

Objektiv Specifik: 2.3 Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Objektivi Specifik: 2.4 Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonat përmes programeve transnacionale.

Shih grafi-konin më poshtë:




Në objektivin 3, janë parashikuar edhe 3 objektiva specifike:

Objektivi Specifik: 3.1 Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;

Objektivi Specifik: 3.2 Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve;

Objektivi Specifik: 3.3 Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Shih grafi-konin më poshtë:



3. RREZIQET DHE HAPAT PËR ADRESIMIN E TYRE

Objektiv Strategjik 1: Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal, parasheh si rrezik dhe sfidë për Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, është Miratimi i Ligjit për Zhvillim Rajonal në Qeveri, si dhe miratimi i akteve nënligjore.

Poashtu themelimi i mekanizmave institucional për hartim, monitorim, dhe vlerësim të programeve/projekteve dhe Zhvillimi i sistemit për matjen e performancës rajonale është një sfidë pasiqë duhet bashkëpunim me institucionet tjera, si dhe mungon komunikimi për raportim.

Objektiv Strategjik 2: Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale

Rrezik sa i përket Objektivit Strategjik 2 është mungesa e komunikimit në Platformat e Qeverisë së Republikës së Kosovës siç është Krijimi i data bazës rajonale me të dhëna socio-ekonomike.

Sfidë dhe rrezik është edhe mos anëtarësimi në programet transnacionale: BALKANMED, ADRION dhe DANUB etj.

Objektiv Strategjik 3: Krijimi i data bazës për Inventarizimin e resurseve natyrore, ekonomike dhe kulturore sipas rajoneve zhvillimore.

Analiza e investimeve nga niveli qëndror në zonat ekonomik

- *MZHR për adresimin e këtyre sfidave ka bërë përgaditjet e nevojshme dhe vazhdimisht i parasheh në planin vjetor për ti adresuar me aktivitete konkrete.*

4. Shtojcat

Shtojca 1: Raporti i monitorimit të planit të veprimit për vitin 2022. Shtojca të tjera mund të ofrohen për të mbështetur dhe ilustruar informacionin e paraqitur më sipër.

Shtojca 1.

Raporti i monitorimit të planit të veprimit për vitin 2022 - Modeli për progresin kundrejt veprimeve

Fokusi i raportit të planit të veprimit është në përfundimin e veprimeve siç parashihet në planin e veprimit dhe arsyet e vonesave, të cilat jepen në shtyllën "Progresi në zbatim".

Nr.	Objektivat dhe veprimet	Afati i fundit	Burimi i financimit	Institucioni udhëheqës dhe mbështetës	Produkti (Output)	Referenca në dokumente	Progresi në zbatim
Objektiv strategjik 1		Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal;					
1.1	Objektivi specifik 1	1.1 Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;					
1.1.1	Hartimi dhe miratimi i kornizës ligjore për zhvillim rajonal të balancuar.	2022	BK	MZHR MF, MIE, ASK	Ligji për zhvillim rajonal të balancuar dhe Aktet nën ligjore të miratuara.		60%
1.1.2	Hartimi i dokumentacionit shpjegues të legjislacionit për zhvillim rajonal të balancuar.	2022		MZHR	Dokumenti shpjegues.		100%
1.2	Objektivi specifik 2	1.2 Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.					
1.2.1	Themelimi i mekanizmave institucional për hartim, monitorim, dhe vlerësim të programeve/projekteve.	2022	BRK	MZHR	Mekanizma institucional funksional.	Vendimi për themelimin e mekanizmave koordinues Plani indikativ tre vjeçar i MZHR-së.	100%

1.2.2	Analiza mbi vleresimin e fushave të nevojshme për investime me impakt rajonal.	2022	BKR	MZHR, Komunitat	Një (1) analizë e hartuar.		100%
1.2.3	Zhvillimi i sistemit për matjen e performancës rajonale.	2022	BKR	MZHR, Komunitat	Sistemi i performancës i funksionalizuar.		100%
Objektivi strategjik 2		Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale;					
2.1	Objektivi specifik 1	2.1 Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve;					
2.1.1	Krijimi i data bazës rajonale me të dhëna socio-ekonomike.	2022	BKR	MF, MZHR, ASK	Data bazë rajonale e krijuar me të dhëna socio-ekonomike rajonale.	Plani indikativ i Punës së Qeverisë.	100%
2.1.2	Identifikimi i investimeve publike nga niveli qendror sipas rajoneve zhvillimore, zberthyer edhe sipas komunave.	2022	BKR	MZHR, MIT, MAPL Raporti i vlerësimit dhe rekomandimit për investime kapitale në nivel lokal.		Raporti vjetor i performancës së komunave.	100%
2.1.3	Pasqyrimi sipas rajoneve zhvillimore të resurseve natyrore.	2022	BKR			Raporti i vlerësimit.	100%
2.2	Objektivi specifik 2	2.2 Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;					
2.2.1	Analiza e investimeve kapitale sipas rajoneve zhvillimore.	2021	BKR	MZHR	Dokumenti analitik i investimeve kapitale në rajonet socio-ekonomik.	Analiza e përfunduar e investimeve	100%

						kapitale.	
2.2.2	Analiza e shpërndarjes së granteve në sektorin privat nga niveli qendror në rajone.	2021	BKR	MF MZHR	Dokumenti analitik i shpërndarjes së granteve dhe subvencioneve në sektorin privat sipas rajoneve socio-ekonomike.	Analiza e përfunduar e shpërndarjes së granteve në bizneset e rajoneve zhvillimore.	100%
2.2.3	Hartimi dhe Implementimi i programit të zhvillimit rajonal me grante për komuna për përmirësimin e infrastrukturës publike.	2022	BKR	MF, MZHR	Investime kapitale në komuna dhe projekte të përbashkëta ndërkomunale.	Raporti vjetor i investimeve kapitale.	100%
2.2.4	Hartimi dhe Implementimi i programit për zhvillim rajonal të balancuar me grante në sektorin privat.	2022	BKR	MF, MZHR	Grante dhe subvencione të shpërndara në sektorin privat me qëllim të reduktimit të pa barazive rajonale. Raportet vjetore.	Raporti vjetor i PZHRB-së i përfunduar.	100%
2.3	Objektivi specifik 3	2.3 Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;					
2.3.1	Hartimi i politikave për zhvillim të balancuar rajonal.	2021	BKR	MZHR, MIE	Politika specifike për zhvillim rajonal të hartuara dhe miratuara (Ligji për zhvillim rajonal, Aktetet nënligjore, dokumentet shpejguese, programet, Koncept dokumentet).	Dy programe : Programi për zhvillim rajonal dhe programi për zhvillim rajonal të balancuar.	100%
2.3.2	Zhvillimi i programit për promovimin e politikave zhvillimore të rajoneve	2022	BKR	MZHR	Plan program për promovimin e politikave zhvillimore të rajoneve	Numri i politikave të promovuara.	100%

	socio- ekonomike.				socio-ekonomike.		
2.4	Objektivi specifik 4	2.4 Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonat përmes programeve trans nacionale.					
2.4.1	Përgatitja e plan programit për anëtarësim dhe kërkesa për anëtarësim në programet: BALKANMED, ADRION dhe DANUB.	2020	BKR	MZHR, MIE	Anëtarësimi në programet trans nacionale BALKANMED, ADRION dhe DANUB.	Pjesëmarrja në programet trans nacionale.	100%
2.4.3	Përgatitja e Planit të bashkëpunimit me sekretariatet e programeve trans nacionale: BALKANMED, ADRION dhe DANUB.	2022	BK	MZHR, MIE	Pjesëmarrja në programe, përfitimi nga fondet e IPA.	Numri i projekteve përfituese nga fondet IPA.	100%
Objektivi strategjik 3		Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.					
3.1	Objektiv specifik 1	3.1 Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;					
3.1.1	Krijimi i data bazës për Inventarizimin e resurseve natyrore, ekonomike dhe kulturore sipas rajoneve zhvillimore.	2021	BK, Donator	MZHR, MPMH, MTI	Data bazë e resurseve natyrore dhe kulturore sipas rajoneve socio-ekonomike.	Plani indikativ i Punës së Qeverisë.	100%
3.1.2	Krijimi i data bazës për identifikimin e burimeve njerëzorë sipas profileve	2022	BK, Donator	MZHR, ASK, MPMS/AP	Data bazë sipas rajoneve socio-ekonomike për fuqinë punëtore sipas	Plani indikativ i Punës së Qeverisë.	50%

	profesionale sipas rajoneve zhvillimore.				profileve profesionale.		
3.2	Objektiv specifik 2	3.2 Ndërtimi i kapaciteteve humane dhe OSHC-ve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve që kontribuojne ne zhvillimin socio-ekonomik rajonal.					
3.2.1	Ngritja e kapaciteteve humane të nivelit lokal për shfrytëzimin e resurseve natyrore, përmes përkrahjes financiare.	2022	BK		Programi për ngritjen e kapaciteteve për shfrytëzim të resurseve në nivel të rajoneve zhvillimore.	Plani indikativ i Punës së Qeverisë.	100%
3.2.2	Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve tek të rinjtë për identifikimin e mundësive të vetëpunësimit dhe krijimin e bizneseve “start up”.	2022	BK, Donator	MZHR OJQ	Trajnime të organizuara, raporti i programit.	Plani indikativ i Punës së Qeverisë.	100%
3.3	Objektiv specifik 3	3.4 Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.					
3.3.1	Ndarja e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) të zonave ekonomike.	2022	BRK	MZHR, Komuna	Grante të ndara, raporti i ndikimit.	KASH 2020-22	80%
3.3.2	Ndarja e granteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese të bizneseve në zonat ekonomike me theks të veçantë për	2022	BKR	MZHR, Komunitat	Grante të ndara, raporti i ndikimit.	KASH 2020-22	100%

	zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar.						
3.3.3	Promovimi i politikave rajonale dhe kushteve të cilat ofrohen për tërheqjen e investitorëve të huaj në rajone zhvillimore.	2022	BRK	MZHR, MTI	Botimi i profileve të zonave ekonomike sipas rajoneve socio-ekonomike.	Plani indikativ i Punës së Qeverisë.	100%
3.3.4	Analiza e investimeve nga niveli qendror në zonat ekonomike.	2022	BRK		Dokumenti analitik për ndikimin e investimeve kapitale në zonat ekonomike dhe rekomandimet.	Plani indikativ i Punës së Qeverisë.	70 %